

Folkpartiet: Partia liberale e Suedisë

Information & Fakta

Folkpartiet është partia liberale e Suedisë. Ideologjia jonë, liberalizmi, bazohet në atë se çdo njeri ka një vlerë të pacenuar. Qëllimi politik i Folkpartiet është që çdo individ të ketë liri dhe mjete për të realizuar ëndërrat e veta. Ne kemi besim në logjikën dhe ndërgjegjen e njerëzve.

Ardhmëria jonë

Zgjedhjet në këtë vit kanë të bëjnë me të ardhmen e Suedisë. Suedia ka nevojë për fuqi konkurrence dhe besim në të ardhmen. Ne i përdorim tri fjalë për të përshkruar politikën tonë: Dituria-Puna-Siguria. Kjo tregon se si ne dëshirojmë që Suedia të fitojë në konkurrencën globale.

Dituria

Ne dëshirojmë të aplikojmë një garancion në lexim- shkrim-llogaritje që në shkollën fillore, të ketë më tepër investim në dituri dhe në nota të mëparëshme. Patjetër duhet të përfundojë keqtrajtimi, grindjet dhe dhuna në shkollë. Prandaj ne dëshirojmë që mësuesit të kenë kompetenca më të mëdha dhe të aplikohet vlerësimi i sjelljes. Ne kemi dëshirë për cilësi më të mira në hulumtim dhe arsimim të lartë.

Puna

Përmes diturisë më të madhe dhe përmes asaj që dituria të zbatohet në idetë e ndërmarrjeve, do të krijohen më tepër vende pune. Shumica duhet të kenë dëshirë të startojnë ndërmarrje, prandaj duhet të bëhet më thjeshtë dhe tatimet të zbriten. Gjithmonë është në dobi të kalohet prej ndihmës në punë, prandaj tatimi do të ulët me një zbritje pune e cila gjë do të ndihmojë ata me të ardhura të dobëta.

Siguria

Në ndërmarrje private, është puna që do të bëjë mirëqenien më të sigurt. Me më tepër para në tatim, jepet mundësi për shërbime mjekësore më të mira si dhe kujdes për të moshuarit. Pritja në rradhë sa i përket shërbimeve mjekësore do të kufizohet dhe garancioni shëndetësor do të bëhet më i mirë, me mundësi që ti vet të zgjedhë mjekun dhe spitalin. Të gjithë të moshuarit në shoqërinë tonë do të përfshihen në një garancion kujdesi, një siguri për të marrë atë ndihmë që nevojitet. Ata të cilët nuk e marrin një vend në banim për të moshuarit, do të marrin paratë në dorë për të blerë ato shërbime që nevojiten. Siguria kundër krimit do të rritet. Të ketë më shumë policë dhe të bëhen hetime për të gjitha krimet. Policia të

ketë mundësi të përdorë metoda më efektive për të luftuar krimet.

Integrimi

Shumë njerëz në Suedi janë të penguar për tu punësuar, nga bashkësia dhe shoqëria, për atë arsye se ata kanë një prejardhje tjetër etnike. Tjetërsimi (izolimi nga jeta shoqërore) po rritet. Përmes punës, shkolla të mira, zonë banimi të sigurta dhe një luftë të papajtuar kundër diskriminimit, ne mund të ndërtojmë Suedin e integruar. Ne liberalët do të luftojmë tjetërsimin përmes punës dhe një garancion-zhvillimi për personat që janë të aftë për punë, garancion diturie në shkollë ku gjuha suedeze ka përparësi, përmes ashpërsimit të luftës kundër diskriminimit dhe të trefishohet numri i policëve të lagjeve në zonat e rrezikuara. Për tu bërë shtetas suedez ne konsiderojmë se duhet njohur në një masë gjuhën suedeze.

Solidariteti global

Folkpartiet është një parti internacionale. Ne e pranojmë globalizimin. Ne dëshirojmë që UE- unioni europian të jetë efektiv, të përqendrohet në çështje pa kufi shtetërore dhe ne dëshirojmë që tregtia e lirë dhe ndihma të rritet. Liria krijohet përmes bashkëpunimit më të madhë dhe mirëkuptimit. Është jashtëzakonisht me rëndësi që Suedia të ketë një politikë të jashtme aktive. Zëri ynë nuk do të jetë i heshtur kur ndodhë një krim. Mbështetje në demokratizim dhe punë për të drejtat e njeriut do të kenë përparësi në politikën e ndihmës.

Barazia

Barazia duhet të jetë më e mirë. Mashkujt dhe femrat sot kanë kushte të ndryshme, mundësi të ndryshme dhe nuk trajtohen njëjtë. Këto dymbëdhjet vitet e fundit, hendeku (dallimi) mes të ardhurave të mashkujve dhe femrave nuk ka ndryshuar. Kjo nuk është e pranueshme.



Folkpartiet

www.folkpartiet.se

020-53 53 53